




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot Br Prot Prot No
20/DPK	01-2743/15
Nr. ftaq Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
2	14.09.2015
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.09.2015, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2515-15 për znj. Edmonda Kelmendi-Shehu – Kryesuese e Burimeve Njerzore në Agjencinë kosovare të pronës, për shkak se është parandaluar konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë znj. Kelmendi-Shehu ka dhënë dorëheqje nga funksioni i saj publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2515-15, për Zyrtaren e lartë, znj. Edmonda Kelmendi Shehu – Kryesuese e burimeve njerzore në Agjencinë kosovare të pronës, dhe njëkohësisht person i autorizuar i biznesit privat “Ekom” sh.p.k., është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtarja e lartë, znj. Kelmendi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ajo ka telefonuar me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast, ka njoftuar se ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit publik.

Dorëheqjen e saj nga funksioni publik e kemi vërtetuar edhe në bazë të Formularit të Deklarimit të pasurisë (03-4633-15) të cilin znj. Kelmendi-Shehu e ka dorëzuar në Agjencinë kundër Korrupsionit me dt. 02.09.2015, pas largimit nga funksioni publik.

**II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

